



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 13.11.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 2 (dy). 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi
<p><i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).</i></p>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit Znj. Alma Lica		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Znj. Alma Lica		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Kryetare e Gjykatës së Apelit, Vlorë		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca dëgjimore u zhvillua në intervalin kohor (12:00-12:21). Trupa gjyqese e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën për ditën e pasnesërme (dt. 15 nëntor, ora 12:00)		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Shpallja e vendimit është shtyrë për seancën e ardhshme		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqese (emrat)	Lulzim Hamitaj - Kryetar i trupit gjyqes; Xhensila Pine - Relatore e çështjes; Olsi Komici - anëtar i trupit gjyqes; asistohen nga sekretarja gjyqësore- Denisa Kosta; prezent pa shkëputje deri në përfundim të seancës dëgjimore		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, prezent pa shkëputje deri në përfundim të seancës dëgjimore		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 10 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi koordinues i KPK.		
Media e pranishme:	largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median"		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vetingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Jo	Trupa gjyqese vendosi të përfundoj hetimin administrativ kryesisht në përputhje me Kreun 7 të ligjit nr. 84/2016, dhe të paraqesë rezultat e tij vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.	Subjekti kërkoj përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, kërkesë që nuk u pranua nga KPK, për të cilën komisioni do të argumentoj shkaqet e mospranimit në vendimin përfundimtar. Subjekti i rivlerësimit konfirmoj vënie në dijeni me rezultatet, materialet e dosjes dhe dokumentet provues të hetimit administrativ, si edhe marrjen e një kopjeje të tyre. Konfirmoj se nuk cënohen asnjë ndër rastet ligjore të konfliktit të interesave me anëtarët e trupit gjyqes, dhe nuk ka pretendime sa i takon përjashtimit të tyre. Konfirmoj njoftimin për seancën dëgjimore brenda një kohe të mjaftueshme 10 ditore me qëllim dokumentimin përfundimtar me shkrim të pretendimeve, të cilën e depozitoj në formë të shkruar, pranë sekretarisë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	<p>Nga Raportet e Vlerësimit të ILDKPI rezultojnë: Në Deklaratën Vetting deklarohen si pasuri të paluajtshme: 1- Apartament banimi, Vlorë, burim krijimi: trashëgimi ligjore nga i ati i subjektit të rivlerësimit. Pjesë takuese 25%. 2. AP. banimi, Tiranë, në vlerën rreth 98 mijë euro, pronë nga k. Sipërmarrjes 2009. Burimi i krijimit: K. huaje 2008 për vlerën 60 mijë euro. Hua në shumën 12 mijë euro nga vëllai i bashkëshortit, vlera prej rreth 21 mijë euro zbritje nga shoqëria ndërtuese. Pjesë takuese 50%. 3. AP. banimi, Tiranë, më 2016, në shumën 60 mijë euro. Burimi i krijimit: Hua marrë në 2016 nga person fizik në vlerën 70 mijë euro. Pjesë takuese 50%. 4. Në pronësi të bashkëshortit deklarohet AP. Banimi, Vlorë, krijuar me k. Shkëmbimi me ndërmarrje në Vlorë. Pjesë takuese 100%. 5. Ndërtese dhe truall funksional, Vlorë, krijuar me leje të Komitetit Ekzekutiv më 1991. Pjesë takuese 100%. 6. Dy njësi, Vlorë, fituar me k. Dhurimi 2016, nga vëllai i bashkëshortit, pjesë takuese 100%. 7. Garazhd, Vlorë, fituar me k. Dhurimi 2016, nga vëllai i bashkëshortit, pjesë takuese 100%. ILDKPI përfundimisht konstatohen se për subjektin e rivlerësimit: Deklarimi është i pasaktë, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurisë, ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.</p>	Të dhëna nga raportet e ILDKPI	<p>KPK ka nisur hetimin kryesisht për të tre komponentët, dhe pasi ka konstatuar se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë sipas ligjit, ka vendosur të mbyll hetimin për komponentin e pasurisë dhe ti kaloj barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016. Komisioni analizoj: Raportin e ardhur nga ILDKPI, dokumentet shoqëruese, deklaratat vjetore të subjektit të rivlerësimit, shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, si edhe informacionet dhe dokumenta shkrese të ndryshme nga institucionet shtetërore e private.</p>
	<p>Relatorja e çështjes, Znj. Pine, referon Raportet e vlerësimit të ILDKPI, Deklaratën Vetting plotësuar nga subjekti, dhe burimet e tjera të provës administruar në hetimin e pavarur administrativ ndjekur nga Komisioni, dhe vendosi të kaloj barrën e provës subjektit të rivlerësimit për një sërë mospërputhesh të deklaratave dhe dokumenteve provues.</p>	Relatori	<p>Komisioni i kalon barrën e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë: Janë konstatuar mospërputhje mes Deklaratës Vetting dhe deklarimit periodik të 2009 sa i takon burimit të krijimit të disa prej pasurive të deklaruara. Për pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme. Për mungesë dokumentacioni ligjor provues për burimin e krijimit të të ardhurave nga shtetasit nga ku është marrë huaja, (për të provuar se huadhënësit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë huanë). Për k. e huasë marrë nga vëllai i bashkëshortit rezultojë se huatë janë deklaruar në 2013, dhe nuk janë deklaruar në deklaratat periodike 2009-2012. Subjekti deklarues, i vëllai i bashkëshortit, nuk rezultojnë që ka dhënë hua në vlerat e pretenduara vëllait të tij. Nuk ka dokument provues që shoqëria tregtare të ketë ulur vlerën e çmimit të p.p. në rreth 20 mijë euro. Lidhur me dhurimet nga vëllai i bashkëshortit, ky subjekt deklarues nuk rezultojnë që ne deklarimin periodik 2016 të ketë deklaruar dhurimin e këtyre pasurive. Për mos deklarim të të qënurit ortak të bashkëshortit të subjektit me 34% në shoqëri ndërtimi. Për pasaktësi në dokumentacionin e automjeteve të deklaruara etj.</p>
	personalisht	Mbrojtja	
	Kundërshton konstatimet e Komisionit. Parqet argumentet provues në formë të shkruar. Nuk parashtron shpjegime në seancë	Subjekti i rivlerësimit	
	nuk ka Përfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetari e trupit gjykues të KPK. Konfirmim se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Ankesa nga publiku Përfaqësuesi i ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Nuk kanë nivelin e provueshmërisë. Komisioni ka vendosur ka vendosur të mbyll hetimin vetëm për komponentin e pasurisë	Të dhëna nga raportet e DSIK	Raporti Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar, dhe verifikimet e grupit të punës
	Nuk kanë nivelin e provueshmërisë. Komisioni ka vendosur ka vendosur të mbyll hetimin vetëm për komponentin e pasurisë	Relatori	
	personalisht	Mbrojtja	
	Kundërshton konstatimet e Komisionit. Parqet argumentet provues në formë të shkruar. Nuk parashtron shpjegime në seancë	Subjekti i rivlerësimit	

	nuk ka Përfaqësuesi I ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Ankesa nga publiku Përfaqësuesi I ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Nuk kanë nivelin e provueshmërisë. Komisioni ka vendosur ka vendosur të mbyll hetimin vetëm për komponentin e pasurisë	Të dhëna nga Inspektoriati I Këshillit të Lartë të Drejtësisë	Komisioni ka vendosur ka vendosur të mbyll hetimin vetëm për komponentin e pasurisë
	Nuk kanë nivelin e provueshmërisë. Komisioni ka vendosur ka vendosur të mbyll hetimin vetëm për komponentin e pasurisë	Relatori	
	personalisht	Mbrojtja	
	Kundërshton konstatimet e Komisionit. Parqet argumentet provues në formë të shkruar. Nuk parashtron shpjegime në seancë	Subjekti I rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
	Përfaqësuesi I ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Përfaqësuesi I ONM	
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore u prezantua e rregullt, ndjekur nga disponueshmëria e stafit koordinues të Komisionit dhe etika profesionale dhe e sjelljes së trupës gjykuese. Konstatohet se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat procedurale si më poshtë: është njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit dhe për përbërjen e trupës gjykuese, për të cilën ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi; i janë dhënë 10 ditë kohë për tu njohur me dosjen, për të disponuar kopje të saj, dhe për të paraqitur shpjegime, prova e komente. I rezervohet e drejta e mos përgjigjes dhe depozitimit të pretendimeve përfundimtare. Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera publike të interesuara, Avokati i popullit dhe mediat lokale nuk është çenuar. Seanca dëgjimore shtyhet për ditën e pasnesërme, me qëllim shpalljen e vendimit.		